

**KONTRATË DHURIMI**  
**"KUOTASH"**

Sot më 13/10 /202 2 ortaku i shoqërisë "**Carpathia Albania**" sh.p.k. me NIPT **L41629009A** dhe me adresë Rruga "Pavarësia", ndërtesa nr.1, Kati i Tretë, Zyra 340 dhe magazinë, Mëzez, Kashar, Tirane, **Z. Burim Latifi**, lindur në Vranje, me datën 28/07/1984 identifikuar nga Leternjoftimi lëshuar nga Republika e Serbise datë 11/08/2015 me nr 007126278 dhe **Z. Marsel Mali**, lindur në Tirane, me datën 21.02.1993 identifikuar nga Leternjoftimi Nr J30221049Q. Të dy palët si dhuruesi dhe pranuesi janë dakord me dhurimin e kuotave.

**Palët janë:**

**Dhuruesi: Z. Burim Latifi**, lindur në Vranje, me datën 28/07/1984 identifikuar nga Leternjoftimi lëshuar nga Republika e Serbise datë 11/08/2015 me nr 007126278.

**Pranuesi: Z. Marsel Mali**, lindur në Tirane, me datën 21.02.1993 identifikuar nga Leternjoftimi Nr J30221049Q.

**Neni 1: Objekti kontratës**

Objekt i kësaj kontrate është dhurimi i pjesëmarrjes në përqindje 100% të **Z. Burim Latifi** që zotëron tek shoqëria "**Carpathia Albania**" sh.p.k. për tek **Z. Marsel Mali**.

**Neni 2: Vlera e dhurimit**

Palët bien dakord që vlera e dhurimit të 100% të pjesëmarrjes në përqindje që **Z. Burim Latifi** ka tek shoqëria "**Carpathia Albania**" sh.p.k. është ajo e vlerës 100.000,00. Këto kuota do i dhurohen **Z. Marsel Mali**. Palët nuk kanë asnjë pretendim kundrejt njëri-tjetrit, përsa i përket këtij neni.

**Neni 3: Kalimi i pronësisë**

Hyrja në fuqi e kontratës do te realizohet kur nënshkruhet nga palët. Ekzekutimi i veprimeve për kalimin e plotë të pronësisë do të realizohet pranë Q.K.B.

**Neni 4: Të drejtat dhe detyrimet e Dhuruesit**

**Dhuruesi** merr përsipër, garanton dhe siguron pranuesin se deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe të nënshkrimit të Kontratës, kuotat e mësipërme janë:

1. Të lira nga cdo lloj barre dhe pengu;
2. Nuk jane objekt i ndonje konfliktit gjyqësor
3. Nuk ka persona të tretë që të kenë pretendime në lidhje me pronësinë mbi këto kuota.

**Pranuesi** është i detyruar të paguaje tatimin mbi të ardhurat nga dhurimi, në qoftë se do të ketë, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

**Neni 5: Të drejtat dhe detyrimet e Pranuesit**

Ai ka të drejtë të gëzojë i qetë kuotat nga **Dhuruesi** dhe në rast të kundërt, të kërkojë nga ky i fundit të zgjidhë konfliktin që mund të vijë nga të tretët, për probleme të lindura përpara datës së dhurimit së kuotave.

**Neni 6: Interpretimi i kontratës në tërësi**

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.

**Neni 7: Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni**

Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, janë objekt shqyrtimi para Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**DHURUESI**  
**Burim Latifi**



**PRANUESI**  
**Marsel Mali**

